

NJOFTIM

Drejtuar Z/Znj. _____ **Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit** _____)

Per nje shtese ne rendin e ditës te mbledhjes se Asamblesë se Aksionareve date 26 Prill 2016, sipas kërkesës se paraqitur nga aksionaret Monika Milo dhe Maltin Korkuti ne përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, rendi i ditës se mbledhjes date 26 Prill 2016 behet si me poshtë:

1. Propozim per miratimin e ndryshimeve ne adresën e Zyrave Qendrore te Bankës Credins sh.a
2. Propozim për themelimin e shoqërive aksionare: Bursa Shqiptare e Titujve ALSE dhe Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG.
3. Propozim për miratimin e limiteve te investimit te Credins Bank ne kompanitë ALSE dhe ALREG per nje periudhe 5 vjeçare.
4. Propozim për dhënien e kompetencave të plota Drejtorit te Përgjithshëm të Bankës Credins sh.a., z. Maltin KORKUTI për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore e manaxheriale në emër e për llogari të Bankës Credins sh.a. për licencimin dhe vënien në funksion të kompanive ALSE dhe ALREG.
5. Propozim per miratimin e shitjes se objektit ne pronësi te Bankës Credins me adrese: Bulevardi "Zogu I Pare" pranë ish Bussines Center Veve".
6. Propozim per dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Administruese te Fondit te Pensionit SiCRED sh.a me rend dite si me poshtë:
 - a. Mbi miratimin e pasqyrave financiare vjetore të audituara të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Vullnetar SiCRED sh.a. dhe shpërndarjen e rezultatit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015.
 - b. Mbi miratimin e pasqyrave financiare vjetore të audituara të Fondit të Pensionit Vullnetar "SiCRED Pensions" për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015.
 - c. Mbi miratimin e buxhetit vjetor te Shoqërisë Administruese te Fondit te Pensionit SiCRED sh.a. per vitin 2016;
 - d. Mbi miratimin e shtesës së kapitalit aksionar të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a. në përputhje me kërkesat e ligjit për nivelin minimal të kapitalit.
 - e. Ceshtje te tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane me 12.04.2016

